



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 29.05.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit
2. Projektligji “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Jorida Tabaku, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Roland Xhelilaj, Arben Pëllumbi, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Edmond Spaho, Fatbardha Kadiu, Dashamir Shehi, Nadire Meçorapaj dhe Edmond Haxhinasto. Pjerin Ndreu, Ismet Beqiraj dhe deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Mungojnë:

Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Agron Shehaj, Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Pandeli Majko – Ministër Shteti për Diasporën

Mimoza Dhëmbi – Drejtoreshë e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.

Në rendin e ditës së punës së këtij komisioni është projektligji “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, paraqitur nga ana e qeverisë. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi lidhur me aspektet financiare të këtij projektligji. Komision përgjegjës është Komisioni për Politikën e Jashtme.

Do të duhet të zhvillojmë një debat lidhur me termat financiare të projektligjit dhe natyrisht t’i dërgojmë një relacion të qartë komisionit përgjegjës lidhur me këtë çështje.

Relator i këtij projektligji është zoti Anastas Angjeli.

Për këtë arsye ndodhet sot në komisionin tonë ministri i Shtetit për Diasporën, zoti Pandeli Majko.

Do të procedojmë me prezantimin nga ana juaj për këtë çështje, zoti Majko dhe më pas me relatorin e komisionit.

Fjala për ju.

Jorida Tabaku – Dua t’i kërkoj ndjesë zotit Majko dhe kolegëve të Ministrisë së Financave, sepse për herë të parë vini në Komisionin e Ekonomisë, zoti Majko, por jam e sigurt që do të jeni dakord me gjërat që do të them, sepse njiheni si njeri i drejtpërdrejtë. Në fakt, edhe fjalët tuaja nga muaji shtator e këtej, kanë qenë shumë të drejtpërdrejta. Mbaj mend fjalën tuaj për rezultatin e zgjedhjeve, kur diskutuam rezolutën për zgjedhjet, zoti Majko, që ishit i sinqertë dhe i drejtpërdrejtë me të gjithë kolegët. “Aty ku nuk kam takuar kriminelë” – thatë, “aty ka shkuar në gropë rezultati”. Nisur nga ky fakt dhe aftësia që keni për t’i thënë të vërtetat në sy, si për ne, si për kolegët socialistë, sot dua të ndaj me ju, së pari, por edhe me gjithë kolegët e komisionit...

Erion Braçe – Do t’ju kërkoja ndjesë deputetëve, të ruajnë seriozitetin. Çështja është shumë serioze!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur ta drejtosh ti, po! Kur e drejtoj unë, ndërhyj unë!

Jorida Tabaku – Kështu që besoj se si ju, ashtu edhe të gjithë kolegët socialistë dhe qytetarët shqiptarë janë të interesuar të dinë se çfarë do të ndodhë në 28 qershor. A do të hapen

negociatat me Shqipërinë më 28 qershor? A është qeveria e Shqipërisë duke bërë çdo gjë që është në dorën e saj për hapjen e negociatave, për të luftuar krimin dhe korrupsionin, për luftën kundër drogës, për mbrojtjen e minoriteteve, për mbrojtjen e pronës, për një administratë publike të papolitizuar?

Më vjen keq të them që kjo nuk është e vërtetë! Më vjen keq të them se më 28 qershor, Shqipëria do të ketë vështirësi për hapjen e negociatave, ashtu siç thonë vendet anëtare, sepse shërbimet e vendeve anëtare janë duke raportuar që Shqipëria po kthehet në një problem serioz për krimin, për ndëshkimin e korrupsionit në nivele më të larta dhe, “nivele më të larta” i referohem nivelit të ministrave dhe Kryeministrit. Shqipëria po kthehet në një problem serioz për drogën në rajon.

Zoti Majko, ju duhet të jeni ministri me më shumë punë i kësaj qeverie. Jemi rasti unik në botë ku shqiptarët po ikin jashtë më shumë sesa ata që po qëndrojnë. Kështu që puna për ministrinë tuaj, në qoftë se do ta kishit marrë në këndvështrimin që ne ju sugjerojmë ta merrni, duhet të ishte voluminoze, sepse shqiptarët po largohen përditë e më shumë nga ky vend dhe arsyeja është krimi i lidhur me qeverinë, është fakti që shqiptarët sot nuk shohin të ardhme në vend dhe kërkojnë ta gjejnë atë jashtë.

Dy ministra të brendshëm të lidhur me trafikun e drogës, të cilët sot janë turpi i Shqipërisë dhe po pengojnë integrimin e Shqipërisë! Faktet që janë paraqitur për hetimin dhe vendimin final të Gjykatës së Apelit për vëllain e ministrit të Brendshëm në një vend normal, do të kishte rrëzuar një qeveri, dhe jo një ministri të Brendshme. Faktet e lidhjes së tij të drejtpërdrejtë me trafikun e drogës do të kishin rrëzuar një qeveri dhe jo një ministri të Brendshme, ndërkohë që ne sot gjendemi sikur këtu nuk ka ndodhur asgjë.

Sot, shqiptarët duan një përgjigje nga qeveria se çfarë do të ndodhë me krimin, korrupsionin, drogën dhe këtë përgjigje ende nuk po e marrin.

Sot, të rinjtë shqiptarë janë duke kërkuar një përgjigje pse në administratën publike ka punësime politike dhe nuk ka mundësi punësimesh për të rinjtë shqiptarë.

Sot, të rinjtë shqiptarë, zoti Majko, fatkeqësisht janë duke e kërkuar shpresën jashtë vendit dhe ky është faji jonë, i politikës, por në radhë të parë, është faji i qeverisë, që nuk po ofron një Shqipëri më të mirë këtu.

Sot, të gjithëve si politikanë duhet të na vijë turp, që Shqipëria në të gjithë vendet anëtare, po diskutohet si vend që ka lidhje me drogën, krimin dhe korrupsionin.

Fatmirësisht, sot në opozitë jemi ne, sepse në një vend tjetër opozita do të kishte bërë atë që bëri Partia Socialiste, do të ishte përpjekur të pengonte liberalizimin e vizave, të NATO-s dhe çdo proces tjetër, por deri më 28 qershor Partia Demokratike dhe opozita ka vendosur që për hir të procesit të integritetit të marrim pjesë në komisione dhe të përpiqemi të sillemi normalisht. Por kjo nuk na pengon t'i ngremë këto shqetësime.

Për këtë arsye, përsëris edhe një herë kërkesën e Partisë Demokratike për dorëheqjen e ministrit të Brendshëm, përsëris edhe një herë kërkesën e të gjithë qytetarëve shqiptarë dhe të gjithë të rinjve shqiptar për një shtet normal, për një vend normal, përsëris edhe një herë kërkesën që më 28 qershor qeveria ta marrë seriozisht dhe të përpiket të realizojë çdo objektiv për hapjen e negociatave.

Sot fatkeqësisht në burg janë vetëm 4 kuksianë! Sot fatkeqësisht në burg janë vetëm 4 të papunë që punonin për të mbijetuar, që punonin për bukën e gojës, ndërkohë që sot jashtë dyerve të burgut janë 2 ministra të lidhur drejtpërdrejtë me trafikun e drogës.

Shpresoj shumë që të bëni një thirrje, që këtë muaj të fundit që ka mbetur, të gjithë bashkë të përpiqemi të arrijmë hapjen e negociatave, jo sepse e meriton qeveria, por sepse qytetarët shqiptarë meritojnë më shumë nga ne, meritojnë më shumë nga politika dhe ne duhet ta ofrojmë këtë.

Për këtë arsye i kërkojmë qeverisë të shikojë edhe një herë dorëheqjen e ministrit të Brendshëm, të shikojë edhe një herë seriozisht plotësimin e prioriteteve dhe të mos merret me propagandë, të mos merret me batuta bajate, të mos merret me humor e tallje, por të mendojë një herë të vetme në këta 5 vjet për të ardhmen e shqiptarëve dhe të rinjve shqiptarë.

Faleminderit!

Erion Braçe – Fjalën e ka zoti Spaho.

Edmond Spaho – Faleminderit, zoti kryetar!

Prej një muaji, ju e dini që kemi hyrë në një marrëdhënie të kushtëzuar me Kuvendin e Shqipërisë, duke pasur si kërkesë tonën dorëheqjen e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafa për lidhjet që ai ka me botën e krimit nëpërmjet vëllait të tij Agron Xhafa, i cili është dënuar në Itali për formim të organizatave kriminale dhe trafik droge ndërkombëtar.

Kaq do të mjaftonte që në një vend normal, demokratik, të binte qeveria, jo më të japë dorëheqjen ministri i Brendshëm, por këtu nuk jemi në një shoqëri demokratike, pavarësisht se pretendojmë dhe përpiqemi të hiqemi si të tillë.

Ditën e shtunë u zhvillua një protestë e qytetarëve shqiptarë, në thelb të së cilës ishte kjo kërkesë: ministri i Brendshëm të japë dorëheqjen. E patë sa masive ishte protesta dhe pavarësisht përpjekjeve që bëte për ta denigruar, poshtëruar, apo tallur, qytetarët u derdhën masivisht në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit”. Po ashtu, patë, në ambientet e Ministrisë së Brendshme sesa e lartë është pakënaqësia qytetare. Ajo ka arritur në një pikë vlimi, saqë u desh të ndërhynin drejtuesit e Partisë Demokratike, deputetët e saj, zoti Basha për t’i frenuar për të kapërcyer sjelljen normale në një protestë qytetare.

Po kështu, patë reagimin ndërkombëtar, thellësisht pozitiv ndaj protestës dhe kërkesave të qytetarëve të këtij vendi. Të gjitha mjetet dhe stacionet televizive të rëndësishme, folën, komentuan, shkruan që qytetarët shqiptarë janë të pakënaqur me qeverinë e tyre për shkak të lidhjeve që ka ajo me krimin e organizuar. Sigurisht, ky model qeverisjeje shfaqet në gjithë jetën politike, ekonomike dhe shoqërore.

Gjendja e vështirë në të cilën ndodhet Shqipëria sot, mungesa e punësimit, rënia e të ardhurave, varfëria, emigrimi masiv, në thelb të tyre kanë këtë model qeverisjeje, qeverisjen e përbashkët të krimit me rilindjen.

Kërkesa për dorëheqjen e Fatmir Xhafës është e panegociueshme, e patolerueshme nga opozita. Ne kërkojmë që ai të japë dorëheqjen në mënyrë që i vëllai i tij, i cili deri ditën që e larguat nga Shqipëria ka qenë i përfshirë në aktivitete kriminale, të mund të hetohet në mënyrë të paanshme. Ai nuk mund të hetohet për sa kohë që i vëllai i tij është në pozicionin e ministrit të Brendshëm.

Dëshirojmë të çlirohet policia, e cila prej 5 vjetësh është kapur nga klanet e drogës. Më parë kishit ministër të Brendshëm Sajmir Tahirin, i cili, sot, në thonjëza “hetohet”, është në ndjekje penale për pjesëmarrje në aktivitete kriminale. Pas tij, vendin e zë një eksponent tjetër, i cili gjithashtu nëpërmjet vëllait të tij ka të njëjtën histori të turpshme të lidhjeve me bandat e drogës. Nuk ka në Partinë Socialiste, nuk ka në Rilindje njerëz të tjerë, të cilët mund të marrin këto përgjegjësi? Sigurisht, edhe ne si opozitë e dimë që ka! Ka pafundësisht njerëz të ndershëm edhe në këtë forcë politike, por është Kryeministri Rama, i cili zgjedh, do dhe insiston që të mbajë këtë kategori në pozicionet drejtuese më të rëndësishme të drejtimit të shtetit, në mënyrë që të shpëtojë veten e tij, pasi të gjitha indicet që dalin nëpër media janë që edhe ai, së bashku me të vëllain është i lidhur me rastin e Xibrakës.

Në këtë mënyrë, me mosdorëheqjen e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafa, me ç'ka ngjau dje edhe me ish-ministrin Saimir Tahiri, po i pritet rruga hapjes së negociatave.

Dje, edhe një herë pamë sesa fals është hetimi që po ndiqet gjoja nga prokuroria, pamë që u vërtetuan ato që ka thënë opozita prej muajsh se ju doni ta kapni prokurorinë që të mos hetoni Saimir Tahirin. Ju emëruat në shkeljet të ligjit prokuroren e Përgjithshme, po ushtroni presion ndaj gjyqësorit nëpërmjet vetingut dhe rezultati është që Saimir Tahiri dje doli i lirë si të gjithë qytetarët e tjerë dhe gjoja po hetohet në gjendje të lirë. Ata katër fakirët e Kukësit rrinë në burg, kurse Saimir Tahiri del dhe gjezdis i lirë, Mark Frroku del dhe gjezdis i lirë, ky është efekti i të ashtuquajturës reformë në drejtësi. Shembulli më i qartë është lirimi i Mark Frrokut, lirimi i Saimir Tahirit dhe mbajtja e 4 kuksianëve në burg.

Pra, që drejtësia ka degjeneruar, prokuroria dhe gjyqësori kanë degjeneruar në një nivel të papranueshëm, mjafton t'i referoheni fjalës së ambasadorit amerikan, i cili ju tha: "Ka prova nga burime të sigurta që ushtrohet presion dhe janë ofruar para për të liruar Saimir Tahirin". Kush e ushtron presionin dhe kush ofron para? Opozita? Jo! Maxhoranca, ajo është e interesuar ta mbrojë Saimir Tahirin, siç e ka mbrojtur deri tani, sepse do t'i zbulohen lidhjet vetë Kryeministrit, Edi Rama.

E patë deklarinimin pas lirimit të Saimir Tahirit, ku ambasada amerikane u shpreh se gjykata vendosi jo mbi fakte dhe prova, por mbi presione? Kjo është shumë e rëndë për këtë maxhorancë dhe në raste të tilla, siç e thashë edhe më sipër, do të binte qeveria. Por këtu nuk kanë turp, as skuqen dhe as zverdhen, janë të vendosur në atë rrugën e tyre. Gjoja përpiqen për happe negociatash dhe ia hedhin fajin opozitës, e cila po u bëhet pengesë.

Opozita prej vitesh ka investuar në integrimin dhe hapjen e negociatave të vendit me Bashkimin European, madje edhe ky qëndrimi që po mbajmë këtë muaj synon që t'i japim shembuj konkretë, të saktë, prova që po luftohet krimi i organizuar dhe po priten lidhjet e tij me qeverinë. Ju në vend që ta plotësoni këtë detyrë, të vetmin kusht që ju kanë vënë disa vende anëtare të Bashkimit European, bëni hapa të tjerë prapa, duke liruar edhe atë që ishte në arrest shtëpiak dhe vazhdoni të mbani ministrin e Brendshëm kur nuk keni arsye se pse duhet të mbahet një person i tillë, me lidhje të tilla në pozicionit të ministrit të Brendshëm.

Ne do t'i vazhdojmë përpjekjet tona që të plotësohen kriteret, kushtet, së paku kushti themelor, të cilin e citova më sipër, për hapjen e negociatave, më pas është përgjegjësia juaj nëse

negociatat do të dështojnë dhe ju do të përballeni më ashpër dhe më fort me zemërimin e qytetarëve të këtij vendi.

Erion Braçe – A mbaruat, zoti Spaho?

Edmond Spaho – Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit juve!

Kam tri gjëra fare shkurt.

Së pari, nuk e di kur jeni serioz, kur hidhni këngë dhe valle apo kur flisni në këtë komision.

Së dyti, ju dëgjova që thatë se është e panegociueshme. Në këtë komision askush nuk po negocion asgjë.

Së treti, ju thatë se ajo që bëjnë prokurorët dhe gjykatësit është shumë e rëndë për këtë maxhorancë. Më vjen keq, por kjo nuk ka asnjë lloj lidhjeje me ne. Prokurorë janë ata që keni emëruar ju në kohën tuaj, gjykatës, ata të tre dhe të tjerë, janë po ata që keni emëruar ju në kohën tuaj dhe kjo nuk ka lidhje fare me ne.

A e dëshiron ndonjë tjetër fjalën?

Urdhëroni, zoti Shehi!

Edmond Spaho – Nuk dua të bëj replikë me ju, sepse e di se çfarë këngë ke kënduar dhe do ta vazhdosh ta këndosh, por po të kujtoj që...

Erion Braçe - Unë nuk këndoј...

Edmon Spaho - ... Prokuroren e Përgjithshme, po të kujtoj prokuroren e Krimeve të Rënda, po të rikujtoj edhe një herë citimet e ambasadorit amerikan...

Erion Braçe – Zoti Spaho, kolegët tuaj...

Edmond Spaho - ... para dhe pas çlirimit të Tahirit që është ushtruar presion dhe janë ofruar para.

E dyta, gjykata vendosi jo mbi prova dhe fakte, por vendosi mbi presione.

Faleminderit!

Erion Braçe – Zoti Spaho, besoj se kolegët tuaj, që merren me çështje të jurisprudencës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, duhet ta kenë mësuar që Prokuroria e Përgjithshme nuk ka asnjë lloj ndikimi mbi çështje konkrete, por i zoti i çështjes konkrete është prokurori Hajdarmataj së bashku me të gjithë kolegët e tij atje, të cilët edhe dje kanë kërkuar arrest me burg...

Edmond Spaho – Je bërë si Ali komiku...

Erion Braçe – Mjafton të mos bëhem si Lulzim komiku. Si çdokush tjetër bëhem, por si Lulzim komiku, jo.

Edhe një herë po ju them se dje prokurorët kanë kërkuar arrest me burg për Saimir Tahirin. Në qoftë se keni ndonjë problem me gjykatësit, ju lutem shumë, drejtojuni KLD-së, e keni tuajën, e zotëroni nga i pari deri tek i fundit, prandaj drejtojuni atyre, sepse ata i kanë emëruar dhe ata i mbajnë në detyrë...

Kush e do fjalën?

Po, zoti Shehi.

Dashamir Shehi – Mua do të më pëlqente të flisnim për Fondin Shqiptar të Diasporës, sepse kam shumë ankesa për sa i takon kësaj pune. Jam i kënaqur që po merremi me këtë punë, sepse gjysmën e shqiptarëve e kemi jashtë, por nuk më pëlqen mënyra se si ministria, së bashku me ministrin që e drejton atë, përcjellin mesazhin që nga Shqipëria duhet të shkojnë jashtë dhe anasjelltas.

Por këtë çështje do ta lë ta diskutojmë në detaje një ditë tjetër, sepse gjykoj se sot kryefjala e të gjitha punëve është: a do të vazhdojmë me këtë lloj situatë? Personi, i cili mbrëmë ishte në arrest shtëpie dhe i shihte ndeshjet nga kolltuku, tani do t'i shohë nga lokali i bastit që ka afër shtëpisë. Pra, ish-ministri i Brendshëm. Vazhdojmë me faktin që mbrëmë kanë arrestuar, si e kishte emrin ai dëshmitari, kjo është shumë e bukur dhe komedi po ta mendosh, pra ai që denoncoi vëllain e ministrit të Brendshëm, sepse kaloi për në Kosovë, ndërsa i denoncuari nuk arrestohet për ta çuar në Itali, dhe këtu mbyllet muhabeti. Mos u merrni fare me komente të tjera, vetëm kjo qëndron. Merruni seriozisht me këtë punë, nuk ka rëndësi se si e mendon partia juaj apo partia jonë, por mendoni se si na shohin partitë e tjera, që na shohin nga Europa.

Po si mund të hyjmë në Europë me këta njerëz, me këta ministra të Brendshëm? Për çfarë na akuzon Europa? Europa na akuzon për drogë, për korrupsion dhe shumë muhabete të tjera, por nuk na akuzon për varfërinë tonë. Po të ishin këta ministra të Ekonomisë, siç po debatohet në Itali, do të ishte hall i madh, por për Shqipërinë ata njohin vetëm dy veta, Kryeministrin dhe ministrin e Brendshëm. Ministrat e Brendshëm të Shqipërisë, rresht pas rreshti, janë njerëz të kriminalizuar dhe këtu mbyllet puna. A e kanë fajin këta, fëmijët e tyre, kunetërit apo vëllezërit, kjo nuk ka fare rëndësi për ne, absolutisht. As për ju nuk duhet të ketë fare rëndësi se kush e ka

fajin dhe as nuk na duhet, por na duhet se çfarë perceptimi ka Europa për këta njerëz, teksa ne mendojmë të futemi në Europë, dhe këtu duhej të ishte mbyllur diskutimi.

Kjo që ka ndodhur këtu, e cila po thuhet natë për natë nëpër televizione, është pa precedencë për të dy ministrat, i pari akuzohet se ka vënë policinë për të mbjellë drogën, ndërsa tjetri ka fshehur të vëllanë dhe bën sikur s'e di që është i vëllai dhe se çfarë ka ndodhur me të. Pra, me këto gjëra ne po e paragjykojmë në mënyrë definitive hyrjen në Europë.

Ne si opozitë, përtej demonstratave, e dimë shumë mirë që i vetmi shans që kemi për të qëndruar është Europa. Jashtë Europës një grup me Edi Ramën në krye, me arrogancën dhe ekstravagancën e vet, për disa vjet mund t'i bëjë ballë presionit të brendshëm, por atij të Europës nuk ka se çfarë t'i bëj. Ne shpresojmë dhe urojmë të futemi në Europë, pasi kemi bërë çdo gjë për t'iu afruar Europës në vitet që kemi pasur pushtet, kemi bërë çdo gjë për të mos ju penguar ju t'iu afroheni Europës, sepse keni justifikimin më absurd që mund të ketë një maxhorancë. Shqipëria nuk ka pasur asnjëherë ndonjë maxhorancë më të madhe se juaja. Ju ngjani me atë përrallën “Delja me ujkun”, ku ujku akuzon qengjin se më turbullon ujin poshtë. Çfarë ju turbullojmë ne? Ju keni 75 deputetë dhe 5 apo 6 i keni marrë apo i keni blerë këtë brenda, pra gjithsej bëheni 80 deputetë. Me cilin ligj ju pengojmë ne ju? Ju doni të na mbyllni edhe gojën, të mos denoncojmë asgjë. Keni pasur maxhorancën më absolute, më arrogante që ka pasur ndonjëherë Shqipëria dhe megjithatë vazhdoni të ankoheni se ju pengojmë ne. Kush ju pengon? Dy apo katër vitet e para ju pengonin borxhet e qeverisë së vjetër, të cilat u mbyllën, a ku e di unë se çfarë bëtë me to, ndërsa dy vitet e dyta ju pengoi sistemi i drejtësisë, sepse nuk ju linin prokurorët. Nuk mbillet misri në Lushnjë, e ka fajin drejtësia, përmytet Shkodra, e ka fajin drejtësia, nuk prodhojnë hidrocentralet, e ka fajin drejtësia! Keni gjetur justifikimin më absurd dhe kur vjen puna, edhe drejtësinë sot e keni tuajën.

Ndërsa tani, vitin e parë ju paska pasur fajin jo drejtësia, por LSI-ja, që ka qenë ortakja juaj, por nuk ju kanë shkuar punët mirë. Ju asnjëherë nuk jeni justifikuar me punë, e megjithatë ne po ju themi që përtej kësaj bëni çfarë të doni, por mos e ngatërroni Shqipërinë dhe integrimin europian me disa grupe banditësh këtu, sepse ky do të jetë krimi më i madh, dhe mos kujtoni se nuk do të dalë. Të gjitha letrat janë nëpër prokuroritë e Europës dhe do ta shihni kur t'iu hapet kapaku këtij katafalku, se çfarë ere e qelbur do të dalë.

Pra, ne po ju ofrojmë një detantë, besoj se shumica e kuptojnë fjalën, për këtë muaj, nuk kemi për ta bërë gjithmonë, sepse po ta vësh tjetrin me shpatulla për muri atje në qoshe, jo njeriu,

por edhe një kafshë reagon. Pra, ne po ju ofrojmë një detantë dhe urojmë të mos e shpërdoroni këto katër javë. Çfarë po ju kërkojmë? Po ju kërkojmë të hiqni dy njerëz që janë turp për ju, sepse edhe ju keni sëkëlldi, pasi po të pish kafe veç e veç me ju, të gjithë kështu do të flisni si unë. Për çfarë e bëni këtë? Për unitetin e partisë? Ju e bëni thjesht dhe vetëm për një gjë, nga frika prej zotit Rama, sepse ky është lidhësja e të gjitha këtyre këpucëve të vjetra, ky i bën bashkë të majtë dhe të djathtë, sepse nuk ka asnjë lloj logjike tjetër. Besoj se kur shkoni në darkë në shtëpi, edhe ju flisni me njerëzit tuaj dhe e kuptoni fare mirë se çfarë po ndodh.

Pra, edhe një herë, ju ftojme të reflektoni. Armët e opozitës për denoncimin janë protestat dhe debatet. Mitingu i fundit e tregoi këtë, por edhe vetë zoti Basha. Nuk ka protestë që nuk ka brenda 10 sherrxhinj, por unë besoj se kjo ishte ndër demonstratat më paqësore, nisur nga motivi që kishte. Kështu që unë do t'ju ftoja të gjykoni qetësisht dhe t'u bëni presion institucioneve tuaja.

Sa i përket ligjit të diasporës, do të diskutoja në një ditë më të qetë se kjo, sepse të gjithë kanë dyshime sa i përket operacionit.

(Ndërprerje incizimi)

Klevis Balliu - Duke marrë parasysh diskutimet dhe faktin që asnjë nga maxhoranca nuk ka kthyer ende përgjigje për shumë pyetje që kanë bërë qytetarët shqiptarë, përfshi këtu edhe ju, zoti kryetar, pavarësisht se bëtë një replikë, ky është një sulm ndaj opozitës që lidhet edhe me justifikimet që përmendi zoti Shehi. Unë mendoj që sot është rëndësishme për secilin nga ne, është, gjithashtu, në interes të qytetarëve shqiptarë të marrim disa vendime konkrete, së pari, dorëheqjen e ministrit të Brendshëm, dhe kjo për 1100 arsye.

Lidhja e Agron Xhafajt me krimin e organizuar dhe me drogën nuk është akuzë, por një fakt konkret. Zotëria sot është në burg. Një ministër të Brendshëm me vëllain në burg nuk ka asnjë shtet të Europës që të mund ta pranojë.

Sa i përket hapjes së negociatave me keqardhje them se nuk kam asnjë besim që ato negociata, do të hapen, për shkak se dje kjo maxhorancë u vuri shkelmin kur nxori nga burgu Saimir Tahirin, por u vuri shkelmin edhe kur nxori nga burgu Mark Frrokun. Si ka mundësi që kjo maxhorancë nuk arriti në këto 5 vjet të mbrojë një herë një gazetar, por vetëm i sulmon ata? Si ka mundësi që kjo maxhorancë nuk arriti një herë të mbrojë një doktor, një profesor, por vetëm i sulmon ata? Si nuk arriti një herë të mbrojë artistët, por po u shkatërron teatrin?

Kur erdhi puna te narkotrafikanti Elvis Roshi, çdo deputet ishte në mbrojtje të tij; kur erdhi puna te Mark Frroku çdo deputet i maxhorancës ishte në mbrojtje të tij; kur erdhi puna te Saimir Tahiri, çdo deputet i maxhorancës dhe analist ishin në mbrojtje të tij; edhe kur erdhi puna tek Agron Xhafaj, çdo deputet ishte në mbrojtje të tij. A nuk e gjetët dot kohën për të mbrojtur një herë një gazetar si zoti Kasmi, që goditet barbarisht nga një polici, e cila ka humbur çdo të drejtë për të kërkuar llogari.

Së dyti, duhet të jeni realistë me qytetarët shqiptarë. Meqenëse zoti Xhafaj donte të bënte vetingun në polici, duhej ta fillonte nga vetja, sepse, edhe pse pyetjet i ka bërë vetë, prapë nuk e kalon vetingun.

Ju po bëni shou me ligjin e diasporës, që është i nevojshëm, por që ju nuk keni asnjë buxhet real për atë projekt, sepse nuk e arrini dot kurrë. Ju diasporës mund t'i bëni vetëm atë që u bëtë institucioneve të shtetit, atë që i bëtë shoqërisë shqiptare, inkriminimin. Kjo është linja që keni ndjekur ju. Për mua është absurd që komisionet parlamentare që mund të diskutojnë ndonjë gjë tjetër përveç luftës kundër krimit dhe drogës ndërkohë që ata hyjnë sot në korridoret e Ministrisë së Brendshme sikur të ishin pronarë të atyre institucioneve. Disa media, të cilat paguhen me paratë e drogës u nxituan të flisnim për protestën, por të gjithë ne këtu, përfshi edhe Edi Ramën, jemi koshientë se çfarë ishte ajo protestë. Nëse nuk i vini gishtin kokës, ajo protestë do të ketë përshkallëzim, i cili nuk është në interes as të opozitës, as të maxhorancës dhe as të qytetarëve shqiptarë. Do të përshkallëzohet situata dhe pastaj do të jetë e pamundur për opozitën t'i mbajë qytetarët shqiptarë, sepse irritimi ka arritur kulmin, varfëria ka arritur kulmin, droga ka arritur kulmin. Vetëm një gjë nuk arrin kulmin në Shqipëri. Çfarë ju mungon, deti, mali apo klima që ka Shqipëria? Jo, nuk mungon asgjë, por kemi korrupsionin, i cili promovohet, kontrollohet nga bandat, banditët që sot janë veshur me kostume politikanësh. Unë nuk e besoj që është çdo deputet i Partisë Socialiste i përfshirë, ose çdo socialist, sepse do të ishte marrëzi, por unë fajësoj çdo deputet sepse nuk po ngre zërin.

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste është kthyer në një grup parlamentar memec, flet një kryetar, flet një ministër që është i përfshirë vetë. Ku janë deputetët e qarkut të Vlorës, Fierit? Pse është kthyer Vlora nga një vend i turizmit në vendin e banditëve? Sepse atje është deputet Edi Rama dhe, ku shkel ai, mbin droga. Ai është një njeri që vuan kur sheh një narkotrafikant që nuk e njeh. Edhe kur e sheh në ndonjë vend tjetër që nuk ka lidhje me atë, prapë e vuan, sepse e sheh si sojin e tij. Largojeni atë të parin!

Ministri i Brendshëm duhet të japë dorëheqjen për çështje morale. Fakti që nuk jep dorëheqjen, sjell pikëpyetje të mëdha. Ai duhet të japë dorëheqjen për sa kohë e ka vëllain në burg. Fakti që nuk e jep dorëheqjen, ngre pikëpyetje të mëdha, sepse me imunitetin e ministrisë së Brendshme nuk e mbron dot të vëllain. Prandaj, në qoftë se doni të vazhdoni lojërat dhe filmat vazhdojini, por do të vijë një moment që duhet të përgjigjeni, dhe duhet t'u përgjigjeni qytetarëve shqiptarë.

Edmond Spaho – Zoti kryetar,

Zotërinj të maxhoranës,

Mesazhin tonë ne jua dhamë, jua ripërsëritëm dhe do të vazhdojmë t'jua ripërsërisim në të gjitha komisionet parlamentare, në seancë plenare, pasi është qëndrimi i qytetarëve, është pasqyra e normave demokratike me të cilat duhet të qeveriset një vend. Shpresojmë të dëgjoni dhe të reflektoni! Po e përsëris, këtë qëndrim po e mbajmë në interes të integritetit europian të vendit dhe dëshirojmë të japim kontributin maksimal për hapjen e negociatave. Shpresoj që edhe ju të reflektoni, të jepni shembuj dhe të plotësoni kriteret, kushtin që jua kanë vënë disa vende të Bashkimit Europian për hapjen e negociatave. Nëse negociatat nuk do të hapen, përgjegjësia është juaja dhe do të përballeni me reagimet e qytetarëve dhe të opozitës.

Faleminderit!

Erion Braçe – Ju lutem, prisni pak minuta se të vendoset qetësia!

Fatmir, ajo kënga “Lefta, lefta” ishte super.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk e këndoj.

Faleminderit të gjithë kolegëve për durimin e deritashëm! Ata që nuk kishin durim u larguan nga mbledhja e komisionit.

Do të doja t'ju thosha vetëm dy fjalë para se të kalojmë te prezantimi i projektligjit nga ministri Majko.

Së pari, Shqipëria ka marrë një rekomandim pa kushte nga institucioni, që është ngarkuar ta japë këtë rekomandim për Shqipërinë, nga Komisioni Europian, i cili është institucioni që ka analizuar nga fillimi deri në fund Shqipërinë, ka analizuar të gjitha institucionet e saj, ka bërë vlerësime maksimale për secilin prej institucioneve, ka bërë vlerësimin e tij për të mos thënë që ka dhënë votëbesimin për rezultatet e arritura nga qeveria e Republikës së Shqipërisë në të gjithë sektorët, përfshi edhe ekonominë që është elementi kyç i punës së këtij komisioni, ashtu siç ka

bërë vlerësimet themelore për reformën në drejtësi, madje, ka kërkuar që ritmet e zbatimit të asaj reforme të jenë të përshpejtuara dhe, po ju them se sot që jemi duke folur nuk ka asnjë kusht përballë Shqipërisë nga ana e Komisionit Europian.

Pa asnjë lloj diskutimi gjatë javës që shkoi kishte dy forca të rëndësishme politike në protestë, ishte ADF-ja në Gjermani dhe dje mori një përgjigje të qartë e gjithë pjesa tjetër e Gjermanisë në një kundërprotestë, natyrisht ishte edhe një protestë në Shqipëri. Pa asnjë lloj diskutimi unë nuk kam pikë dyshimi që ADF-ja do të vendosë kushte për Shqipërinë, por si ADF-ja mund të ketë edhe forca të tjera politike e të tjera me radhë, por mbeten kushte të këtyre forcave politike. Ajo që ka Shqipëria në dorë është thjesht dhe vetëm të vazhdojë fort me reformat dhe në rrugën që është konfirmuar tashmë nga Komisioni Europian.

Së dyti, mua mëqë m'u drejtuan disa herë si përfaqësues dhe deputet i maxhorancës, do të doja t'ju thosha se nuk më vjen fare turp që ministri i Brendshëm i Shqipërisë është Fatmir Xhafaj. Nga dita që këta kanë nisur sulmin kundër ministrit të Brendshëm, zoti Xhafaj është pritur në Austri nga ministri i Brendshëm i Austrisë, homologu i tij, ndërsa disa ditë më pas është pritur nga ministri i Brendshëm në Holandë.

Pra, këta që flasin në emër të partnerëve tanë ndërkombëtarë, që marrin përsipër të recitojnë edhe kushtet e vendosura nga këta partnerë, që e identifikojnë ministrin e Brendshëm si kusht themelor në këtë histori, duhet ta kenë parasysh pikërisht këtë fakt. Po e përsëris, ministri i Brendshëm është në detyrë, rezultatet e Policisë së Shtetit, në harkun e këtyre muajve, kanë qenë gjithnjë e në rritje, forca goditëse e Policisë së Shtetit ka qenë maksimale, pasi janë zbardhur ngjarje të rënda kriminale, të cilat, për vite të tëra me radhë, mund dhe të mos ishin zbardhur. Kështu që, për të gjithë ata që vendosin kushte brenda Shqipërisë, siç dëgjova disa kolegë këtu që nga mëngjesi, natyrisht unë vazhdoj të them që ne nuk vendosim asnjë kusht për askënd, ne marrim dhe presim kushte vetëm nga qytetarët e Republikës së Shqipërisë dhe mundohemi t'u përgjigjemi. Të tjerët, axhendën e tyre për t'u rikthyer në pushtet, le ta vazhdojnë ta bëjnë si të duan. Qytetarët janë ata që patë ditën e shtunë në bulevardin "Dëshmorët e Kombit", por qytetarët janë edhe ata që nuk i patë fare ditën e shtunë në bulevardin "Dëshmorët e Kombit". Diferenca është shumë e thellë dhe nuk është për shkak të emigracionit, por për shkak të asaj që njerëzit jetojnë dhe perceptojnë këtu, në Shqipëri.

Sa i takon emigracionit, unë vazhdoj të jem i habitur se si ka mundësi që me gjithë kërkesën e vazhdueshme gjatë këtyre 5 vjetëve, me të gjithë amplifikimin e vazhdueshëm për t'u

larguar nga ky vend, deri sot, për fat të mirë apo të keq, nuk shoh asnjë nga politikanët e kësaj ane të largohet nga ky vend, përkundrazi, duhet të shihni deklaratimet e pasurive të tyre ku jo vetëm nuk largohen nga ky vend, por janë bërë, apo vijojnë të bëhen edhe më të pasur se një vit më parë. Ky është problemi.

Zoti Majko, keni fjalën për të vazhduar me prezantimin e projektligjit.

Pandeli Majko – Ju faleminderit!

Zotërinj kolegë, ky është projektligji i tretë, pas dy ligjeve që ka miratuar parlamenti në kuadër të diasporës dhe ligjit për Agjencinë Kombëtare të Diasporës. Nga pikëpamja ligjore është në harmoni të plotë me veprimtarinë që ushtrohet nga institucionet e shtetit shqiptar, por ajo që doja të theksoja, ka të bëjë me disa gjëra të thjeshta. Në thelb projektligji përbëhet nga 18 nene, të cilat rregullojnë frymën organizative dhe parashikojnë çështjet e funksionimit të fondit shqiptar të zhvillimit të diasporës. Në kreun e parë të projektligjit rregullohen çështje të natyrës së përgjithshme, siç janë: objekti, misioni dhe përkufizimet, kurse në kreun e dytë renditen çështje që kanë të bëjnë me burimet e financimit dhe këtu do të nënvijëzoja që jam plotësisht i hapur për të gjitha vërejtjet që do të ketë relatori dhe kolegu Anastas Angjeli. Gjatë diskutimit të këtij projektligji kemi pasur një bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave dhe me ministritë e tjera, pasi normalisht bëhet fjalë për një institucion të ri publik. Është një boshllëk, të cilin projektligji për Fondin e Zhvillimit të Diasporës do ta plotësojë dhe ka të bëjë me gjetjen dhe ndërtimin e një mekanizmin për projektet, që do të organizohen qoftë nga shteti shqiptar, qoftë nga buxheti i shtetit shqiptar, apo dhe nga donatorë të ndryshëm për diasporën. Të mos harrojmë se kemi një numër goxha të madh njerëzish pranë, të cilëve ne po përpiqemi t'u krijojmë mekanizma, që të fillojmë të funksionojnë. Komisioni për Reformën Zgjedhore është duke diskutuar paralelisht të drejtën e votës, por ne nuk mund ta mbyllim me kaq, prandaj mendoj se Fondi për Zhvillimin e Diasporës është një mekanizëm më tepër. E thënë me pak fjalë, ai do të nxisë krijimin e një rrjeti të kapitalit social dhe të filantropisë në diasporë, do të ofrojë një listë të institucioneve dhe projekteve të programeve të besueshme dhe të mundshme, që kanë nevojë për financim, e kështu me radhë.

Pjesa kryesore e ligjit vjen me rregullimet e brendshme të Fondit të Zhvillimit të Diasporës, pasi ka të bëjë me një strukturë rregullash standarde, të cilat, shpresoj se do të kenë mirëkuptimin e të gjithë kolegëve.

Ju ftoj ta votoni!

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Majko!

Fjalën e ka zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Projektligji në fjalë “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës” është një përpjekje serioze për vënien në zbatim të programit të qeverisë për çështjet e diasporës. Siç dihet, është krijuar një ministri e posaçme, e cila kërkon të kompletohet edhe me kuadrin e saj ligjor dhe, natyrisht, edhe me institucionet përkatëse. Kjo e ka bazën e vet në programin e qeverisë, e cila, për periudhën 2017-2021 i ka kushtuar një vëmendje të posaçme, si asnjëherë më parë, politikës me diasporën dhe përfshirjen e saj në të gjitha punët e çuarjes përpara të zhvillimit dhe mirëqenies së vendit. Natyrisht, është vazhdimi i një pakete aktesh, që kanë dalë deri tani, siç është strategjia kombëtare e diasporës për periudhën 2018-2024, ligji për diasporën, të cilat kërkojnë një kompletim me një legjislacion tjetër, me fillimin e zbatimit të tij dhe me ngritjen e disa institucioneve, ku përfshihet edhe institucioni i Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës. Ne kemi një eksperiencë në vendin tonë në krijimin e disa lloj fondesh, pa dyshim ky ka specifikën e vet, sepse trajton disa çështje që kanë të bëjnë me tepër me nxitjen e prirjeve filantropike dhe të investimeve nga kjo kategori e popullsisë, që ndodhet jashtë vendit dhe që përbën një burim të rëndësishëm për realizimin e projekteve të ndryshme në fushën e arsimit, të shëndetësisë, të kulturës, të zhvillimit rural dhe që mund të shfrytëzohet mjaft mirë në dobi të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit tonë në fushat përkatëse.

Pa dyshim kërkohet që ky kuadër ligjor të bëjë disa dallime dhe veçori në identifikimin e investimeve të këtij lloji në raport me investimet e tjera të huaja. Herë pas here vendi ynë ka aplikuar politika të veçanta në favor apo në ndihmë të një investimi të caktuar të diasporës. Tani bëhet fjalë për të pasur një institucion dhe një kuadër me rregullator. Duke qenë hapi i parë nuk mund të pretendohet për përsosmëri, por është një nismë, e cila duhet mbështetur dhe ne, si Komisioni i Ekonomisë për dhënie mendimi, duhet t’ia përcjellim komisionit përkatës me mbështetjen tonë, por duhet bërë edhe disa komente dhe sugjerime për këtë komision, i cili me vendimmarrjen e vet, të bëjë maksimumin për të konsideruar sugjerimet që kemi menduar të japim.

Së pari, mendoj që komisioni përkatës dhe ne duhet të saktësojë llojin e institucionit në mënyrë precize. E them këtë, sepse në nenin 4 është i përcaktuar lloji i institucionit që do të jetë jopublik, kurse në nenin 7 jepen burimet e financimit. Atëherë kërkohet që të jemi shumë preciz,

ose do ta lëmë të jetë institucion jopublik dhe do të pranojnë të gjitha format e dhëna në nenin 7 që konsiderohet një formë mikse e financimit, sepse konsiderohen të ardhurat nga buxheti, nga donatorët dhe të ardhura të tjera, ose do të jetë vetëm për një vit një institucion, që do të mbështetet nga qeveria të paktën për shpenzime personeli dhe administrative, apo dhe për shpenzime të tjera, që të fillojë funksionimin e vet. Kështu që ky saktësim që duhet bërë në nenin 4 dhe në nenin 7 të mbahet shënim nga këshilltarët tanë dhe t'i përcillet Komisionit për Politikën e Jashtme.

Së dyti, këtë sugjerim që bëj te neni 4 dhe te neni 7, e bëj që të mos hyjmë në rregullim nenesh, prandaj i kam konsideruar si pika që do t'ua rekomandojmë, pasi e kanë ata kompetencën, si dhe është i lidhur me pozicionin që mbahet në nenin 16 ku thuhet se për një vit do të mbështetet dhe përcaktohet lloji i mbështetjes. Natyrisht, këtë lloj mbështetjeje nuk mund ta bëjmë ne këtu, sepse janë edhe disa çështje që përcaktohen me vendim qeverie. Mendoj që në nenin 6, gjithnjë duke folur në parim, por po e konkretizoj edhe me nene, sepse e lidh me fjalët që thashë “përcaktohen me vendim qeverie”, pasi të menaxhosh projekte, një fond i tillë duhet të përcaktojë edhe mënyrën, duhet shtuar edhe një pikë, që me VKM të përcaktohet mënyra sido të menaxhohen këto projekte. Mbase do të duhej të saktësohej një mënyrë e raportimit hierarkik të këtij fondi, pavarësisht se ka një varësi, sepse është Ministria e Diasporës. Ajo duhet përcaktuar në ligj, sepse duhet që ky fond të raportojë diku, siç është Fondi i Zhvillimit. Meqenëse kemi një Ministri të Diasporës, duhet të raportojë te ministri, por mund të raportojë edhe në Kuvend, sa herë e thërret, ku ka një Komision për Politikën e Jashtme dhe një Nënkomision për Diasporën. Kështu që ky konsiderohet në sugjerim i pestë, që mendoj se është i domosdoshëm.

Nga ana tjetër ndoshta do të duhej në ligjin për diasporën dhe këtu është rasti ta konsiderojmë. Gjithë kjo diasporë e shtrirë në shtete të ndryshme ka filluar ta ketë të nevojshme të krijojë dhomat e biznesit në vendet e tyre përkatëse. Në Shqipëri kemi Dhomën Amerikane të Tregtisë, Dhomën Angleze të Tregtisë, pra një sërë dhomash dhe shqiptarët që janë jashtë tashmë pas 30 vjetësh janë në gjendje që me djersën dhe punën e tyre të krijojnë biznese dhe dhoma tregtie. Natyrisht, ndoshta do të ishte më e saktë, por këtu ne mund të vendosim që ky fond mund të asistojë dhe të mbështesë me sugjerimet e veta, që ata t'i krijojnë këto dhoma, por në përputhje me legjislacionet e vendeve të tyre. Ata nuk mund të marrin legjislacionin shqiptar në Angli, në Amerikë, në Itali apo në Greqi.

Kështu. Ky është një sugjerim tjetër, që konsideroj se mund t'i bëhet Komisionit të Politikës së Jashtme. Duke qenë se në thelb ka nxitjen e prirjeve filantropike, unë besoj se duhet zgjidhur edhe problemi teknik i dëshirës filantropike. Për shembull, në qoftë se një filantrop shqiptar, që me veprimtarinë e tij të punës jashtë shtetit, do të dhurojë një shkollë në vendlindjen e tij, të bëjë një spital, një vepër, atëherë duhen zgjidhur edhe çështjet teknike të mënyrës së dhurimit të parave, ndoshta një llogari unike në këtë ministri, që të jetë publike për të gjithë. Kjo është një çështje që duhet ta zgjidhë ligji, ta ngarkojë Këshillin e Ministrave, që Banka e Shqipërisë me Ministrinë e Financave, me Ministrinë e Diasporës, ta rregullojnë këtë punë, sepse duhet rregulluar; nuk mund të shkruajmë vetëm ligj, dhe të mos dijë tjetri si të veprojë, nëse ne e kemi vullnetin dhe dëshirën.

Nga ana tjetër duhet parë mirë një sugjerim tjetër në lidhje me këto strukturat, që janë të ndërtuara në ligj, që ne do t'ua rekomandojmë Komisionit të Politikës së Jashtme.

Unë besoj se këto nuk janë sugjerime që ulin vlerën e ligjit, por besoj se janë sugjerime që e pasurojnë atë, e ndihmojnë atë, që në kuadrin e strategjisë, në kuadrin e dy ligjeve të tjera, të bëhet një ligj më i kompletuar dhe më praktik në zbatimin e tij, me qëllim që të mos mbetemi në rrafshin teorik.

Besoj se ne duhet ta mbështesim.

Ju faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Angjeli!

Pyetje. Po, zoti Haxhinasto, urdhëroni!

Edmond Haxhinasto – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti Majko, për prezantimin!

Mendoj se është një projektligj shumë i rëndësishëm për shumë arsye. Mes tjerash, është një element i gjithë tërësisë së përkujdesjes shtetërore, që është detyrim kushtetues ndaj diasporës. Prandaj, besoj se nga të gjithë kolegët do të ketë seriozitet në trajtimin e tij.

Mendoj se sot diaspora ka shumë sfida të jashtëzakonshme. Të gjithë i pranojmë këto sfida, por, me thënë të drejtën punohet relativisht pak. Mendoj se sfidë shumë më e madhe për diasporën është evidentimi i qartë i saj. Sfidë shumë e madhe është regjistrimi i diasporës. Sfidë shumë e madhe është krijimi i një strukture të organizimit të saj atje ku është. Sfidë shumë e madhe është gjithashtu përgatitja e infrastrukturës që do të realizojë votimin, sepse ka shumë vite që është premtim elektorale i partive politike, për të realizuar pjesëmarrjen në votim të diasporës.

Pra, janë shumë elemente, shumë sfida, të cilat në fakt kërkojnë angazhim të shtetit drejt tyre. Ky ligj, siç ka ardhur, duket sikur ka një fluks më të madh prej tyre drejt Shqipërisë, që është pozitiv, duhet krijuar si mundësi, por nuk duhet të harrojmë se kemi detyra edhe këndeja ndaj atyre që janë jashtë.

Kjo është në kuptimin e detyrave funksionale dhe të qëllimeve, që të realizohen nëpërmjet këtij fondi. Si gjë më konkrete kam, për shembull, idenë e shtëpive të shqiptarëve. U përmend këtu çështja e shoqatave të biznesit apo grupeve të biznesit, por mendoj se diasporën duhet ta shikojmë në një dimension pak më të gjerë se sa dimensionin ekonomik, edhe kulturor, të angazhimit kombëtar. Për Shqipërinë mund të luhet një rol i jashtëzakonshëm nëpërmjet aktivitetit të tyre. Pra, më shumë shikoj ato shtëpitë e shqiptarëve, ato qendrat kulturore, se sa shoqatat e biznesit. Jam i bindur se për shoqatat e biznesit, ata nuk do të operojnë në vendet ku janë, por do të vijnë këtu e do të shikojnë situatën. Nuk mund ta ndërmarrin nëpërmjet organizimeve të biznesit.

Thënë kjo, pashë edhe çështjet e financimit. Përveç kontradiktës që ka neni 4 me nenin 7, që u përmend: neni 4 thotë se vepron me vetëfinancim, e pastaj flitet për buxhetin e shtetit. Ka një shprehje, kur flitet për financimin, që thotë: “Orientimi i prirjeve filantropike, i donacioneve dhe investimeve”.

Mendoj se gjëja kryesore për angazhimin e investimeve është aktiviteti këtu, në Shqipëri, i realizuar këtu, në Shqipëri. Unë nuk e di, një biznesmen që mund të marrë vendime investimesh nga vendi ku është pa ardhur, pa njohur situatën, pa njohur tregun. Kështu, duhet të jemi realistë dhe konkretë sa i takon kësaj mundësie.

Duke pasur parasysh sa thashë më sipër, dhe se disa nga nenet duhet t’i shikojmë, duhet të kemi një koncept më të qartë në lidhje me funksionet e këtij fondi. Unë, me thënë të drejtën, këtë fond e shikoj si facilitues dhe financues sa i takon përgatitjes së diasporës për të realizuar qëllimet që janë të drejta, qofshin aktivitete filantropike apo donacione, por më shumë për të riorganizuar dhe për të luajtur rolin në diasporë, për të mbajtur gjallë kulturën, për të mbajtur gjallë gjuhën, për të forcuar lidhjet me shtetin amë. Vetëm nëse këto do të ndodhin, besoj se do të kemi një potencial ekonomik investimesh në Shqipëri. Si radhë prioritar duhet të jemi shumë të kujdesshëm. Duhet të investojmë më shumë te diaspora, që pastaj të presim të na kthehet investimi prej tyre, dhe jo e kundërta.

Kështu, mendoj se kjo duhet riparë dhe duhet të jemi realistë sa i takon rolit të këtij fondi për të shërbyer si një kanalizues i investimeve nga diaspora drejt Shqipërisë. Nuk mendoj se ky fond e ka kapacitetin ta bëjë këtë gjë, po për të facilituar, për të krijuar infrastrukturën, për të krijuar organizimin dhe rrjetin përkatës, këtë besoj se mund ta bëjë.

Theksoj edhe një herë atë që thashë në fillim, që është një premtim i hershëm i kësaj qeverie, i kësaj maxhorance për realizimin e votimit në diasporë. Kjo nuk mund të realizohet në qoftë se nuk ka evidentim, regjistrim dhe krijim të strukturës përkatëse ashtu siç duhet, për të realizuar në mënyrë të pakontestueshme pjesëmarrjen e diasporës në votim, pra, pjesëmarrjen e tyre, vendimmarrjen e tyre në proceset politike në Shqipëri.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Haxhinasto!

Po, zoti Beqiraj, urdhëroni!

Ismet Beqiraj – Përshëndetje!

Duke falënderuar zotin ministër në lidhje me nismën, me projektligjin “Për fondin shqiptar të zhvillimit të diasporës”, unë kam dy pyetje e dy sugjerime.

Pyetja e parë është: ndoshta duhet qartësuar tek neni 5, që ka të bëjë me mbështetjen. Në objektivat e fondit shqiptar të zhvillimit të diasporës, a do të ketë edhe mbështetje të arsimit në gjuhën amë, të fëmijëve shqiptarë, në vendet ku ata janë rezidentë aktualisht? Sepse, si është formuluar te neni 5, pika 2, germa “a”, sikur flet vetëm për kontributin e tyre në Shqipëri, kur thuhet: “zonat rurale”.

Pyetja e dytë ka të bëjë po me mbështetjen financiare, për nevojën e lobimit të Shqipërisë në institucionet e ndryshme politike e financiare ndërkombëtare. A përfshihet në këtë fond?

Te neni 10, te pika 2, që ka të bëjë me detyrat e këshillit drejtues, do të sugjeroja të shtohet fjala “prej tij”, ku thuhet: Këshilli drejtues ka edhe një sekretar, i cili zgjidhet nëpërmjet punonjësve të administratës, por lihet evazive se kush e zgjedh. Prandaj, pas shprehjes “i cili zgjidhet” është me vend të shtohet: “prej tij”.

Në fund, te neni 17, meqenëse i bie të dalë vetëm një vendim i Këshillit të Ministrave, sipas pikës 3 të nenit 9, le të lihet edhe një afat nga një deri në tre muaj, e jo të lihet evazive, që të kalojnë muaj të tërë dhe ligji të bëhet nul pa aktet nënligjore përkatëse.

Faleminderit!

Erion Braçe – Ka ndonjë diskutim tjetër? Pyetje? Ndonjë shqetësim tjetër, përveç atyre që ngriti zoti Angjeli? Nuk ka.

Atëherë, ne si komision për dhënie mendimi, do t'i paraqesim një relacion komisionit përgjegjës, që është Komisioni për Politikën e Jashtme, me opinionet e paraqitura këtu nga relatori, por edhe nga kolegët e tjerë deputetë. Ndërkohë, na duhet të bëjmë sot një votim në parim. Ne e shqyrtojmë projektligjin vetëm në parim, sepse nen për nen shqyrtohet në Komisionin e Politikës së Jashtme. Kështu, do të doja të hidhja në votë projektligjin “Për fondin shqiptar për zhvillimin e diasporës”.

Kush është kundër? Kush është pro? Abstenim nuk ka.

Miratohet!

Zoti Majko, ju faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA